



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .03.2023

MBLEDHJA Nr. 12,
Datë 15.03.2023, ora 13:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 15.03.2023, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 12 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s datë 13.03.2023
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sha, për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sha, për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
4. Mbi fillimin e procedurës për pajisje me certifikatë të Garancisë së Origjinës të impiantit fotovoltaik të prodhimit të energjisë elektrike në digën e Qyrsaqit, Hec “Vau i Dejës”, të shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” sha.
5. Mbi kërkesën e të licencuarve “SUN BEAT SYSTEM” shpk., “TREN SUN SYSTEM” shpk, “ERNI SOLAR” shpk, “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” shpk dhe “NTSP” shpk, për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të kapitalit të tyre si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “RAIFFEISEN BANK” sha.
6. Mbi përfundimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s.
7. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI